



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-30547/23 datë:17.11.2023



Npi – 01/429 datë: 27.11.2023

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (c), nenin 17 shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 6 paragrafi 1 pika 3 e Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.10/2019); Nenin 7 të Rregullores të QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 27.11.2023 miratoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR DISKUTIM PUBLIK TË DRAFT-RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E  
PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM PRONËN KOMUNALE PËR MË PAK  
SE NJË VIT**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VIII-të për vitin 2023, të mbajtur më: 27.11.2023, unanimisht miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Rregulloren Komunale për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim pronën komunale për më pak se një vit, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, dhe Komitetin për Politikë dhe Financa.

**II**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës Komunale për Financa, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi